

VENDIM
Nr. 53, datë 5.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E MARZHEVE TË FABRIKIMIT DHE TË TREGTIMIT TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 50 të ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çmimi maksimal i tregtimit të barnave nga fabrikuesit vendas caktohet duke shtuar deri në 20 (njëzet) për qind mbi koston e fabrikimit. Ky çmim maksimal i tregtimit llogaritet bazuar mbi çmimin EXW.

2. Çmimi maksimal i tregtimit me shumicë të barnave nga importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë caktohet duke shtuar deri në 11 (njëmbëdhjetë) për qind mbi çmimin CIF të importit të barit, e konvertuar në lekë sipas kursit mesatar të njoftuar nga Banka e Shqipërisë, për çdo 6-mujor.

Marzhi 11 (njëmbëdhjetë) për qind ndahet ndërmjet importuesit dhe shpërndarësit, përkatësisht 8 (tetë) për qind dhe 3 (tre) për qind.

3. Çmimi maksimal i tregtimit me pakicë të barnave caktohet duke shtuar deri në 25 (njëzet e pesë) për qind mbi çmimin e blerjes nga shpërndarësi farmaceutik.

4. Për barnat e listës, që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, zbatohen marzhe të diferencuara, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Për barnat, që blihen nga institucionet shëndetësore publike, çmimi maksimal i tregtimit dhe marzhi i fitimit, që do të zbatohen mbi çmimin CIF ose EXW, do të jetë me marzhe të diferencuara, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për barnat, të cilat nuk janë përfshirë në listën bashkëlidhur, do të zbatohet një marzh fitimi deri në 8 (tetë) për qind.

6. Vendimi nr. 543, datë 27.7.2011 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1

TABELA E GRUPEVE TË BARNAVE PËR PËRDORIM NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË VEND DHE MARZHET E FITIMIT QË DO TË ZBATOHEN MBI ÇMIMIN CIF ose EXW TË TYRE.

- GRUPI I

PËR GRUPIN E MËPOSHTËM TË BARNAVE DO TË ZBATOHEJ NJË MARZH FITIMI DERI NË 8 (TETË) PËRQIND.

1. Anestezi reanimacion
2. Dermatologjike
3. Hormonale
4. Organeve sensoriale
5. Metabolizmi dhe trakti tretës
6. Psikiatri
7. Sistemi kardiovaskular
8. Sistemi muskolo-skelektik
9. Sistemi nervor
10. Sistemi respirator

- GRUPI II

PËR GRUPIN E MËPOSHTËM TË BARNAVE DO TË ZBATOHEJ NJË MARZH FITIMI DERI NË 6 (GJASHTË) PËRQIND.

1. Antiinfektive
2. Gjaku dhe organet formuese të gjakut
3. Citostatikë